# Përshkruesit "CAN DO", për Nivelet e Zotërimit të Gjuhës Angleze, Parashkollor K-12

Për secilin nivel të zotërimit të Gjuhës Angleze, nxënësit që mësojnë Anglisht mund të arrijnë **me ndihmë**:

| | Niveli 1 Fillestar | Niveli 2 Elementar | Niveli 3 Mesatar | Niveli 4 Mbi Mesatar | Niveli 5 I Përparuar | Niveli 6 I Lartë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Të dëgjuarit** | .Tregon fotot, fjalët, frazat<br>. Ndjek udhëzimet me gojë për një veprim<br>. Përputh theniet me objektet, figurat ose ilustrimet | . Seleksionon foto, sende sipas udhëzimeve gojore<br>. Ndjek udhëzimet me gojë për dy veprime<br>. Përputh informacionin gojor me sendet, ilustrimet | . Lokalizon, zgjedh, rendit informacionin sipas përshkrimeve gojore<br>. Ndjek udhëzimet me gojë për shumë veprime<br>. Kategorizon ose rendit informacionin gojor duke perdorur foto, sende | . Krahason përmes informacionit gojor funksionet dhe mardhëniet<br>. Analizon dhe zbaton informacionin gojor<br>. Identifikon shkakun dhe pasojën përmes diskutimeve | . Krijon konkluzione nga informacioni gojor<br>. Ndërton modele bazuar ne diskutimet gojore<br>. Bën lidhje nisur nga diskutimet gojore | |
| **Të folurit** | . Emërton sendet, njerëzit dhe figurat<br>. U përgjigjet pyetjeve të tilla si (kush, çfarë, kur ku, cili) | . Bën pyetje me (Kush, Çfarë, Kur, Ku...)<br>. Përshkruan fotot, ngjarjet, sendet, njerëzit, rendit faktet | . Formulon hipoteza, bën parashikime<br>. Përshkruan procese, procedura<br>. Ritregon tregime ose ngjarje | . Diskuton tregime, çështje, koncepte<br>. Raporton pjesë me gojë<br>. Ofron zgjidhje krijuese per çështjet, problemet | . Përfshihet në debate<br>. Spjegon fenomenin, jep shembuj dhe justifikon pergjigjet<br>. Shpreh dhe mbron pikëpamjet | |
| **Të lexuarit** | . Përputh sendet dhe simbolet me fjalët, frazat ose shkrimet ne mjedisin e klasës<br>. Identifikon konceptet per shkrimin dhe karakteristikat e teksteve | . Lokalizon dhe klasifikon informacionin<br>. Identifikon faktet dhe mesazhet e qarta<br>. Zgjedh modelet gjuhësore që shoqërohen me fakte | . Rendit fotot, ngjarje, procese<br>. Identifikon idenë kryesore Përdor kontekstin per të përcaktuar kuptimin e fjalëve | . Interpreton informacionin ose të dhënat<br>. Gjen detaje, të cilat mbështesin idenë kryesore<br>. Identifikon familjet e fjalëve, figurat letrare | . Bën kërkime të grumbulloj informacion nga shumë burime<br>. Nxjerr konkluzione nga tekste të qarta dhe të nënkuptuara | |
| **Të shkruarit** | . Emerton objektet, fotot dhe grafikët<br>. Vizaton në kuadër të pyetjeve<br>. Krijon ikona, simbole, fjalë, fraza që të përcjellë mesazhe | . Harton lista<br>. Krijon skica, fraza, fjali te shkurtra, shënime<br>. Jep informacionin sipas udhëzimeve me gojë dhe me shkrim | . Krijon skeletin e teksteve me tregime ose ato me karakter përshkrues<br>. Krahason karakteristikat e informacionit<br>. Përshkruan ngjarje, njerez, procese, procedura | . Përgjithëson informacionin nga grafikët ose shënimet<br>. Redakton dhe korrekton një shkrim<br>. Krijon ide origjinale ose përgjigje të detajuara | . Përdor informacionin në përmbajtje të reja<br>. Reagon në zhanre dhe diskutime të ndryshme<br>. Ka autorësi në forma/zhanre të shumta të shkrimit | |

Në përdorimin e këtij informacioni duhet të merret në konsideratë ndryshueshmëria e zhvillimit të nxënësve për arsye të moshës, nivelit të klasës, ndryshimit në përvojat mësimore dhe paaftësive të diagnostikuara për të mësuar (nëse aplikohet).